



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

Nr. 48/44 Prot.

Tiranë më, 18/10/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. ARMIR GJIKOLAJ

Nr. 49, datë 18.10.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Klevis Dhigoi
Erjana Pjetri
Ersa Karaj**

**Kryesues
Relatore
Anëtare**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, më datë 18.10.2024, ora 10:30, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Armir Gjokolaj**, me funksion Zëvendës drejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes znj. Erjana Pjetri, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Armir Gjokolaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, z. Armir Gjokolaj, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit (04.07.2023), si Zëvendësudrejtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës.
3. Subjekti i vlerësimit, z. Armir Gjokolaj, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit”, për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 01, datë 24.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Klevis Dhigoi (Kryesues), znj. Erjana Pjetri (Relatore) dhe znj. Ersja Karaj (Anëtare).
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr. 1, datë 24.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Armir Gjokolaj.
6. Relatorja e çështjes, znj. Erjana Pjetri, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 25.07.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e

njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore më datë 26.07.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - a. Formularin e deklarimit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI);
 - b. Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 - c. Formularin e Kontrollit të Figurës, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
 - d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
 - e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018 “Për

- vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI-së Nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”;
 - g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.
- 13.** Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:
- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
 - ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
 - ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
 - ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet;*
 - ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
 - ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
 - ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
 - ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;*
 - ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
 - ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
- 14.** Trupa e Vlerësimit, më datë 17.09.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, me Vendimin Nr. 3, datë 17.09.2024, vendosi:
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj;
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
 - c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
- 15.** Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”,

i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 08.10.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.
17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 18.10.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimi z. Armir Gjokolaj, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij Ligji, ka për objekt deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
22. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Armir Gjokolaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 10.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi **, datë 10.03.2023.
23. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërisë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKIsë, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
26. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- a. Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- b. Deklaratat e interesave private për të gjithë periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
- c. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- d. Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- e. Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- f. Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- a. Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit.
- b. Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme.
- c. Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim.
- d. Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

29.1 Z. Armir Gjokolaj, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI, në vitin 2013, me numër indeksi 11570, dhe ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- a. Para fillimit të detyrës 2013;
- b. Preiodike/Vjetore 2013;

- c. Pas largimit nga funksioni 2014;
- d. Para fillimit të detyrës 2015;
- e. Periodike/Vjetore 2016.

30. ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar.

PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

31. Bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar; (ç) deklarinimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

32. Trupa Vlerësuese hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarinimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

33. Objekt i vlerësimit të pasurisë është **deklarinimi dhe kontrolli i pasurive**, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të.

Trupa e Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;

- a. Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- b. Aktin përfundimtar të kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI;

¹ Raporti nr. ***, datë 31.01.2024, i ILDKPKI-së.

- c. Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore si dhe nga instiucionet private dhe publike;
- d. Dokumentacionin e administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Trupës së Vlerësimit dhe ILDKPKI-së, si dhe përgjigje të pyetjeve të dërguara në rrugë zyrtare.

34. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kërkuar të dhëna nga institucione publike dhe private të cilat në bazë të ligjit janë të detyruara të japin të dhëna. ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u është drejtuar institucioneve të mëposhtme:

- Bankës së Shqipërisë;
- Bankave të niveleve të dyta;
- Institucione financiare jo bankare;
- Agjensia Shtetërore e Kadastrës;
- Drejtoritë Vendore në rreth dhe Zyrat Vendore të ASHK;
- ISSH;
- FSHU;
- 15 Shoqëri Rajonale Ujësjellës – Kanalizime;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- QKB;
- One Albania sh. a;
- Vodafone Albania sh. a;
- Albania Satellite Communications shpk;
- ABISSNET sh. a;
- DIGICOM shpk;
- Regjistri Notaler Shqiptar...etj

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, ARMIR GJIKOLAJ.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria Nr. 1

35. Apartament me sip. 230 m², rruga “Ali Demi”, apartamenti **, hyrja *, Tiranë. Blerë bankës Societe Generale Albania 07.01.2013, Vlora 120.000 euro. Zoterimi 100%. **Burimi:**

1. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ****, datë 14.02.2012, shuma 10.301.534 lekë. Kjo shumë është tërhequr nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor dhe i janë kredituar subjektit në nr. e llogarisë ***** të BKT.
2. Shitje apartamentit me kontratë nr. **** rep, nr. *** kol, datë 20.11.2008, në shumën 1.281.000 lekë.
3. Kursime familjare (deklaruesi, babai, nëna dhe gjyshja e ndjera).

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

1. Kontratë shitblerje nr. ** rep, nr. ** kol, datë 07.01.2013, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 230.2 m², me nr. pasurie ***, në rrugën “Ali Demi”, Tiranë. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: Banka Societe Generale Albania. Çmimi: 120.000 euro, i likuiduar.
2. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 16.01.2013, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 230.2 m², me nr. pasurie ***, në rrugën “Ali Demi”, Tiranë, regjistruar në emër të Armir Gjokolaj.
3. Certifikatë familjare e datës 08.02.2023, ku në përbërje familjare të saj janë: Pal, Tereze, Armir dhe Ch. Gjokolaj.
4. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. regjistri ***, datë 05.11.2012, i cili i ka pranuar lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. ***** Regjistri Themeltar, nr.**** Vendimi, datë 14.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas se cilit është detyruar pala paditëse, shoqëria “INSIG”, të dëmshpërblejë paditësin Armir Gjokolaj si dhe personat e tretë (ndërhyrës kryesorë), Mara, Pal dhe Tereze Gjokolaj, për dëmin pasuror dhe jo-pasuror shkaktuar nga aksidenti, në shumën totale 9.722.738 lekë, e ndarë përkatësisht: Armir Gjokolaj në shumën 1.722.738 lekë si dëm pasuror dhe 2.000.000 lekë si dëm jo pasuror; Mara, Pal dhe Tereze Gjokolaj, secili në shumën 2.000.000 lekë, si dëm jo-pasuror.
5. Prokurë e posaçme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 10.12.2012, lëshuar nga Mara, Pal dhe Tereze Gjokolaj, të cilët kanë caktuar si përfaqësues nipin, djalin e tyre, Armir Gjokolaj, për ta përfaqësuar pranë përmbauesit J. P.
6. Kërkesë për transaksion nga BKT, datë 14.12.2012, nga urdhëruesi J. P, PF, për shumën 10.301.534 lekë në llogarinë e përfutjesit, Armir Gjokolaj, sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 14.02.2012.
7. Kontratë shitblerje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 20.11.2008, për pasurinë e llojit apartament me sip. 42m², me nr. pasurie ****, Mirditë. Shitës: Mara, Pal, Tereze dhe Armir Gjokolaj. Blerës: Gj. L. Çmimi: 1.281.000 lekë, i likuiduar.
36. **ASHK Tiranë - DV Rurale 1, DV Rurale 2, DV Tirana Jug, DV Tirana Veri, DV Zonat e Stimuluara, DV Kamëz Vorë**, me shkresat nr. *** prot., datë 25.09.2023, datë 11.09.2023, datë 28.08.2023, datë 01.09.2023 dhe datë 28.08.2023, nuk konfirmon këtë pasuri në emër te subjektit Armir Gjokolaj dhe personave të lidhur.
37. **ASHK Rrëshen**, me shkresën nr. **** prot, datë 02.10.2023, nuk e konfirmon pasurinë e llojit apartament me sip. 42m², me nr. pasurie ***, të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur.
38. **FSHU**, me shkresën nr. **** prot, datë 10.08.2023, me emnin Armir Pal Gjokolaj, konfirmon një abonent me nr. TRT*****, me adresë “Ali Demi”, Tiranë.
39. **UKT**, me shkresën nr. **** prot, datë 21.08.2023, konfirmon se në emër të Armir Pal Gjokolaj, rezulton kontrata nr. *****, për objektin me adresë: Rr. “Ali Demi”, me status Aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Bashkëlidhur: Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë

16.01.2013, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 230.2 m², me nr. pasurie *****, në emër të Armir Gjikalaj + kopje ID.

40. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se në datë 31.12.2014 nga llogaria e Pal Gjikalaj është tërhequr një shumë prej 998.900 lekë, me përshkrimin “tërheqje për mobilim shtëpie”.

41. BKT, me shkresën nr. ***** prot, datë 14.08.2023, konfirmon se në datë 14.12.2012, në llogarinë e Armir Gjikalaj është transferur nga PF J. P shuma 10.301.534 lekë, me përshkrimin “ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. *****, datë 14.02.2012”. Nga kjo shumë, Armir Gjikalaj ka tërhequr cash në datë 18.12.2012, një shumë prej 10.300.000 lekë. Më pas, në datë 26.12.2012 dhe datë 27.12.2012, ka depozituar cash një shumë prej 8.430.000 lekë, të cilën e ka konvertuar në shumën 60.000 euro dhe së bashku me një shumë tjetër prej 60.000 euro, të depozituar cash në të njëjtën datë, si dhe ka tërhequr cash në datën 28.12.2012, shumën 120.000 euro.

42. OTP Bank, me shkresën nr. ***** prot, datë 04.08.2023, konfirmon se në datë 28.12.2012, Armir Gjikalaj ka depozituar cash shumën 120.000 euro, të cilën në të njëjtën datë e ka transferuar në një llogari tjetër me përshkrimin “blerje apartamenti Ali Demi, Tiranë”.

43. Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:

Shpjegime me shkrim, ku lidhur me shumën e përfituar nga përmbaruesi gjyqësor në shumën 10.301.534 lekë, ndërkohë që sipas vendimit gjyqësor shuma e përfituar në total duhet të ishte 9.722.738 lekë, shpjegoi se, sipas sqarimit që ka marrë nga përmbaruesi gjyqësor:

- a. Kompania INSIG sh.a. do të paguante 24.000 lekë mbi shlyrjen e detyrimit me njoftim vullnetar dhe me kalimin e këtij afati, shuma shkonte 446.205 lekë dhe kalonte për llogari të subjektit përfitues (nuk është paguar me njoftim vullnetar);
- b. Taksa gjyqësore, pagesa psikologut dhe eksperteve të dëmshpërblimit;
- c. Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit datë 05.11.2012, me nr. ***** Regj.

Me Prokurë të Posaçme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 10.12.2012, në bazë të tre pikave të lartpërmendura, përmbaruesi gjyqësor privat J. P ka tërhequr nga INSIG sh.a. shumën 10.301.534 lekë. Kjo shumë, nëpërmjet llogarisë bankare të BKT, është transferuar në llogarinë e subjektit. Praktikën përmbarimore subjekti nuk e disponon pasi kanë kaluar dhe vite sipas deklarimit, nuk përmbajnë afat ruajtje dhe përmbaruesi ka shumë vite që nuk e ushtron më këtë aktivitet. Shuma prej 10.301.534 lekë, përfituar nga dëmshpërblimi dhe shuma 1.281.000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit në Rrëshen, janë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, me pëlqimin e familjarëve për arsyen se janë një familje dhe nuk kanë gjë të ndarë (mes tyre). Familja është përbërë nga: Mara Gjikalaj (gjyshja e cila ka ndërruar jetë në datë 24.12.2016), prindërit e subjektit, subjekti dhe vajza e tij, Ch. Gjikalaj. Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar se vajza, fëmija i tij, ka lindur jashtë martese, nuk ka bashkëjetuese.

Familja nga viti 1971 deri në vitin 2017 kanë jetuar tek apartamenti (tjetër në Rrëshen), i shitur në vitin 2017. Pas vitit 2017, familja jeton në apartamentin në Tiranë. Për sa i përket shpenzime të mobilimit të

apartamenteve, subjekti shpjegoi se apartamenti me sip. 42 m² në Rrëshen është blerë i mobiluar, ndërsa, apartamenti në Tiranë është blerë pjesërisht i mobiluar dhe kompletimi i tij është kryer duke tërhequr nga banka shumën 998.900 lekë. Bashkëlidhur, paraqiti:

- a. Deklaratë e thjeshtë, datë 30.10.2023, lëshuar nga Pal Gjokolaj, i cili lidhur me apartamentin në Rrëshen, të shitur në vitin 2008, shpjegon se: *“apartamenti është blerë në datën 19.10.1993 për Mara Gjokolaj, nga fëmijët e saj, me të ardhurat nga pagat dhe me pas ka kaluar në pronësi te tij. Në këtë apartament, nëna nuk ka jetuar asnjë ditë por e ka dhënë me qira deri ne datën 20.11.2008 kur dhe u shit. Shuma 1.281.000 lekë, e përfituar nga shitja e apartamentit në vitin 2008, në dijeninë e tij, u është dhënë njerzve të nënës, në periudha të caktuara nga vetë nëna, deri më datë 07.01.2013, kur është blerë apartamenti. Në datën 07.01.2013, kur është blerë apartamenti në Tiranë, nëna i ka dhënë subjektit 1.650.000 lekë, të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 2008, të ardhura nga qiraja, si dhe nga përfitimet që i kanë dhënë njerëzit e saj për përdorimin e shumës 1.281.000 lekë. Në vijim të deklaratës së tij, Pal Gjokolaj shpjegon se kur ishte pyetur nga djali për burimin e këtij apartamenti, i ka thënë nga legalizimi, se kështu i kujtohej pasi kishin kaluar 30 vite”. Ka bashkëlidhur:*

- Kontratë shitje, datë 19.10.1993, për apartamentin (me sip. 42m²) në pallatin nr. **, në Rrëshen. Blerës: Pal Gjokolaj. Shites: F. D. Çmimi: 130.000 lekë, i likuiduar.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 04.11.2008, për apartament me sip. 42m², me nr. pasurie *****, Mirditë, regjistruar në emër të Pal Gjokolaj + Kartela e pasurisë + Harta treguese e regjistrimit.
- Deklaratë e thjeshtë datë 31.10.2023, lëshuar nga Pal Gjokolaj, ku duke qenë se Drejtoria e Arkivave Lezhë nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij, ka bërë një përllogaritje për të ardhurat në periudhën 1967 - 2004.
- Deklaratë e thjeshtë datë 31.10.2023, lëshuar nga Pal Gjokolaj, ku duke qenë se ISSH Tiranë, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij, ka bërë një përllogaritje për të ardhurat në periudhën 2009 - 2014.
- Deklaratë e thjeshtë datë 31.10.2023, lëshuar nga Tereze Gjokolaj, ku duke qenë se Drejtoria e Arkivave, nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së saj, ka bërë një përllogaritje për të ardhurat në periudhën 1967 - 2004.
- Deklaratë e thjeshtë, datë 31.10.2023, lëshuar nga Tereze Gjokolaj, ku duke qenë se ISSH Tiranë nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij, ka bërë një përllogaritje për të ardhurat në periudhën 2010 - 2014.

44. Me proces-verbalin e datës 14.11.2023, lidhur me faktin se sipas kontratës se shitjes, apartamenti ishte blerë nga babai i tij dhe jo nëna (gjyshja), subjekti shpjegoi se kontrata e shitblerjes së apartamentit ishte lidhur në emër të babait, por ajo ka qenë blerë nga fëmijet e saj për gjyshen. Arsyet se përse kontrata e shitblerjes është lidhur në emrin e babait dhe jo në emër të saj, subjekti nuk i di. Edhe për shumën prej 1.287.000 lekë, të përdorur nga shtetas të tjerë dhe kthimin e shumës së bashku me disa përfitime te tjera, subjekti nuk ka dijeni se cilit prej familjarëve gjyshja u'a ka dhënë. Gjithashtu, shpjegoi se edhe për periudhën e qiradhënies se apartamentit nuk disponon te

dhëna dhe dokumente. Gjyshja ka ndërruar jetë dhe subjekti e ka të pamundur një informacion të tillë.

Konstatim i Trupës së Vlerësimit:

- ❖ Subjekti i vlerësimit z. Armir Gjokolaj, nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me diferencën e shumës së pretenduar të përfituar nga gjyshja (e ndjera) nga dhënia e apartamentit me qira në qytetin e Rrëshenit për vlerën prej 363.000 lekë.
- ❖ Vlera e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Rrëshenit referuar kontratës së shitblerjes nr. ***rep, nr. *** kol, datë 20.11.2008, është në vlerën e 1.287.000 lekë.

45. Me postën elektronike të datës 26.09.2024, subjekti deklaroi në prapësime si më poshtë vijon:

“...Kontratë e thjeshtë nga babi, Pal Gjokolaj, që mban datën 30.10.2023, ku shprehet për këtë vlerë. Për shkak të moshës së thyer nuk është në gjendje të shpjegojë se këto të ardhura janë pasqyruar me kontratë qiraje noteriale...”

- ❖ **Në deklaratën e shtetasit Pal Gjikota, (të cilës subjekti i vlerësimit i referohet si kontratë e thjeshtë) trupa e vlerësimit konstaton edhe një herë faktin që një deklaratë dore e dhënë nga babai i subjektit të vlerësimit nuk ka fuqinë provuese të një dokumentacioni sikurse është kontrata e qirasë sipas legjislacionit civil në fuqi konkretisht neve 803 e vijues të Kodit Civil. Mungesa e “kontratës së qirasë në hetimin e Trupës së Vlerësimit të bazuar në ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar rezulton si mosparaqitje dokumentacion justifikues.**

Konkluzion:

Trupa e Vlerësimit referuar analizës financiare, në përfundim të hetimit konstaton se: në lidhje me krijimin e pasurisë, apartament banimi me sip. 230 m², rruga “Ali Demi” Tiranë, subjekti i vlerësimit **ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e saj.**

- ❖ **Konfirmohet deklarimi i subjektit me shpjegimet e dhëna, dokumentacionin e paraqitur dhe konfirmimet e FSHU, UKT, BKT dhe OTP Bank. ASHK nuk e konfirmon regjistrimin e këtij apartamenti në emër të subjektit, për të cilin subjekti ka paraqitur certifikatë për vërtetim pronësie.**

Shuma e shpenzuar për mobilimin e apartamentit në Tiranë në vitin 2017 nga subjekti, deklarohet në shumën 998.900 lekë.

Dokumentacioni për të ardhurat e prindërve është i evidentuar me poshtë, në rubrikën e të ardhurave të tyre.

Pasuria Nr.2

- 46.** Apartament me sip. 84.36m², rruga “Plazh – Plepa”, apartamenti **, hyrja **, Durrës (blerë me mandat bankar nëpërmjet noteres më datë 13.10.2016. Vlera 2.300.000 lekë. Zotërimi 100%.

Burimi:

1. Shitja e automjetit me targë AA***KR, në pronësi të nënës me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016, në shumën 15.000 euro.
2. Kursime familjare (deklaruesi, babai dhe nëna).

***Sqarim:** Shuma 2.300.000 lekë, dhënë nga nëna, me datë 23.09.2016, për të blerë apartamentin dhe njuhësuar me noter deklarata më datë 24.11.2017, nr. *** rep (kredituar në llogari bankare dhe nga kjo shumë është transferuar nëpërmjet llogarisë bankare të noteres G. B).

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. **** kol, datë 13.10.2016, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 84.36m², me nr. pasurie ****, në rrugën “Plazh”, Durrës. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: shoqëria “Kristi Konstruktion 2003” sh.p.k. Çmimi: 2.300.000 lekë, i likuiduar nëpërmjet llogarisë bankare të deklaruesit.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 18.10.2016, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 84.36m², me nr. pasurie ****, në rrugën “Plazh”, Durrës, regjistruar në emër të Armir Gjokolaj.
- Vërtetim noterial nr. **** rep, nr. **** datë 24.11.2017, i deklaratës së lëshuar nga Tereze e Armir Gjokolaj, me datë 23.09.2016, të cilët kanë deklaruar se, në këtë datë, Tereze Gjokolaj i ka dhuruar djalit të saj Armir Gjokolaj një shumë prej 2.300.000 lekë për blerjen e një apartamenti, në Durrës. Shuma 15.000 euro (me kursin e këmbimit të datë 23.09.2016 rreth 2.000.000 lekë) është marrë nga shitja e automjetit Volkswagen me targa AA *** KR, ndërsa, shuma 300.000 lekë, nga kursimet e tyre ndër vite.
- Kontratë shitblerje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 12.12.2014, për automjet Volkswagen Bora. Blerës: Tereze Gjokolaj. Shitës: M. M, Çmimi: 3.000 euro, i likuiduar. + Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016, për automjet Volkswagen Bora (targa AA***KR). Shitës: Tereze Gjokolaj, përfaqësuar me prokurë nga Armir Gjokolaj. Blerës: N. Xh. (Çmimi: 15.000 euro i likuiduar).

Trupa e vlerësimit referuar **deklarimit të mësipërm të subjektit** të vlerësimit zhvilloj një hetim të hollësishëm mbi burimin dhe mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në vitin 2016, të bazuar në prova dhe faktet e dorëzuara nga subjekti i vlerësimit, si dhe duke marrë korrespondence më institucionet publike/private në vend ku me konkretisht:

- 47. ASHK Durrës**, me shkresën nr. *** prot, datë 06.10.2023, konfirmon se, Armir Gjokolaj ka të regjistruar në pronësi apartamentin me sip. 84.36 m², me nr. pasurie *****, në rrugën “Plazh”, Durrës.

Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje nr. **** rep, nr. ***** kol, datë 13.10.2016, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 84.36 m², me nr. pasurie ****, në rrugën “Plazh”, Durrës. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: shoqëria “Kristi Konstruktion 2003” sh.p.k. Çmimi: 2.300.000 lekë, i likuiduar nëpërmjet llogarisë bankare + dokumentet pronësore.
- Urdhër pagese në Union Bank, datë 17.10.2016, ku evidentohet se Armir Gjokolaj ka urdhëruar transfertën e një shume prej 2.300.000 lekë, me përshkrimin “blerje apartamenti, lagjia **, Plazh, me nr. pasurie ****, me sip. 84.36 m², me nr. rep **** dhe nr. kol *****”.

48. FSHU, me shkresën nr. **** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se në emrin Armir Pal Gjokolaj, identifikohet një abonent me nr. kontrate DUIE*****, me adresë Durrës/Kavajë.

49. UKD, me shkresën nr. **** prot, datë 16.08.2023, konfirmon se në emër të Armir Gjokolaj, rezulton kontrata nr. *****, me adresë: Lagjia nr. **, Durrës. Bashkëlidhur: Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 18.10.2016, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 84.36 m², me nr. pasurie ****, në rrugën “Plazh”, Durrës, regjistruar në emër të Armir Gjokolaj.

50. Union Bank, me shkresën nr. **** prot, datë 16.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, në datë 17.10.2016, ka depozituar cash një shumë prej 2.300.000 lekë, me përshkrimin “shitje apartamenti”, shumë të cilën e ka transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e noteres me përshkrimin “blerje apartamenti, lagjia **, Plazh, me nr. pasurie ****, me sip. 84.36m², me nr. rep **** dhe nr. kol 2133”.

51. DPSHTRR, me shkresën nr. **** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA***KR. Bashkëlidhur:

- Faturë shitje (në italisht, përkthyer në shqip), datë 06.11.2014, njuhësuar me nënshkrim noterial nr. **** rep, datë 12.12.2014, për automjet Vlkswagen Bora, vit prodhimi 2000. Shitës: Auto e Veicoli Commerciali, Itali. Blerës: M. M. Çmimi: 1.800 euro.

- Deklaratë doganore datë 04.11.2014, për zhdoganim automjeti Volkswagen Bora, me marrës M. M. Vlera e automjetit: 1.800 euro. Pagesa e zhdoganimit: 54.453 lekë.

- Kontratë shitblerje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 12.12.2014, për automjet Volkswagen Bora. Blerës: Tereze Gjokolaj. Shitës: M. M. Çmimi: 3.000 euro, i likuiduar dhe pala blerëse deklaroi se nuk ka pretendime për gjendjen teknike.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016, për automjet Volkswagen Bora (targa AA***KR). Shitës: Tereze Gjokolaj, përfaqësuar me prokurë nga Armir Gjokolaj. Blerës: N. Xh (çmimi: 15.000 euro, i likuiduar). + Prokurë e posaçme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.07.2016, lëshuar nga Tereze Gjokolaj, ku cakton si përfaqësues Armir Gjokolaj, për të shitur automjetin Volkswagen, me targa AA***KR. + Fotografi të automjetit.

52. Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:

Sqarime me shkrim, ku lidhur me konstatimin në kontratën e shitblerjes së datës 13.10.2016, ku nga palët është pranuar se çmimi shitjes së apartamentit është likuiduar, ndërkohë që transfertat e shumës 2.300.000

lekë në Union Bank ka ndodhur ditë me pas, në datë 17.10.2016, subjekti shpjegoi se ky ka qenë një gabim material i noterës. Edhe për përshkrimin e konstatuar në Union Bank në depozitimin e shumës 2.300.000 lekë, ku është cituar “shitje apartament”, subjekti sqaroi se edhe ky përshkrim është bërë gabimisht nga punonjësi i bankës. Për sa i përket shpenzimeve të mobilimit për këtë apartament, subjekti shpjegoi se ky apartament ka mbetur 1 vit i pa mobiluar dhe mobilimi i tij është kryer më pas me mobiliat e apartamentit të shitur në Rrëshen referuar kontratë së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol, datë 27.12.2017. Lidhur me shitjen e automjetit tip Volkswagen Bora me targë AA***KR, nga nëna e tij në vitin 2016, në shumën 15.000 euro, kur ky automjet ishte blerë në vitin 2014, në shumën 3.000 euro, subjekti ka sqaruar se nuk ka pasur njohje as me shitësin dhe as me blerësin e këtij automjeti. Automjetin e ka përdorur në qytetin e Gjirokastrës kur i ka shkuar një shtetas i quajtur Nino (nuk e di emrin e saktë), ku i ka kërkuar që t'i shiste automjetin me çdo çmim pasi kishte pasur kujtime familjare. Subjekti i dha çmimin e shitjes prej 15.000 euro dhe ai ra dakord. **Bashkëlidhur, paraqiti:**

- Deklarat të lëshuar nga notere G. B, e cila deklaroi se ka bërë gabim material në hartimin e kontratës nr. ***** rep. nr. ***** kol, datë 13.10.2016, ku ka shkruar “ishte likuiduar”, duhet “është dakord të likuidohet”.

-Nxjerrje llogaria nga Union Bank, datë 02.11.2023, ku evidentohet se Armir Gjokolaj, në datë 17.10.2016, ka depozituar cash një shumë prej 2.300.000 lekë, me përshkrimin “shitje apartamenti”, shumë të cilën e ka transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e noterës, me përshkrimin “blerje apartamenti, lagjja **, Plazh, me nr. pasurie *****, me sip. 84.36m², me nr. rep *****dhe nr. kol *****”.

→ **Me proces-verbalin e datës 14.11.2023,** subjekti sqaroi se lidhur me faktin se në kontratën e blerjes së automjetit, emri i blerësit quhet N. Xh dhe jo Nino, sipas deklarimit të subjektit, shpjegoi se shtetasi që ka deklaruar (i quajtur Nino), në momentin e blerjes së automjetit, ka ardhur se bashku me një familjarin e vet. Lidhjen e tyre për momentin nuk e kujton. Pra, deklaroi se shtetasja N. Xh ka qenë familjare e shtetasit të quajtur Nino.

→ **Me postën elektronike të datës 15.11.2023,** lidhur me blerjen e apartamentit me sip. 84.36m², rruga “Plazh – Plepa”, nën kostot e EKB-se, subjekti shpjegoi se: “...ka qenë i interesuar për të blerë një apartament plazhi për prindërit e moshuar dhe për vete. Ka marrë kontakt me shumë shoqëri ndërtuesish ku ka parë shumë apartamente të cilat një pjesë e tyre i kanë pëlqyer por çmimi i tyre i lartë nuk përballon prej tij. Në listën e këtyre apartamenteve ishin dy apartamente të pa-shitura nga shoqëria “Kristi Konstruktion 2003” sh.p.k., njeri që u ble nga subjekti dhe një tjetër ishte në tarracën e pallatit, i pa mbaruar dhe që do të shfrytëzohej e gjithë tarraca. Përsa i përket kostos sipas të dhënave të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave, për qytetin e Durrësit, në vitin 2016, subjekti shpjegoi se nuk ka dijeni, dhe kjo nuk ishte bërë e ditur as nga shoqëria ndërtuese, as nga noterja, por ka qenë një dakordësi midis palëve për blerjen e këtij apartamenti. Nuk ka qenë i interesuar për koston pasi apartamentet shiteshin me çmime të ndryshme sipas vendit (vijë e parë, dytë etj...). Përsa i përket ortakëve të shoqërisë “Kristi Konstruktion 2003” sh.p.k., subjekti shpjegoi se nuk ka asnjë njohje apo kontakt me ta, kontakti i vetëm ka qenë për blerjen e këtij apartamenti...”.

→ **Me postën elektronike të datës 16.11.2023,** në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti sqaroi se pas interesimit të tij, edhe kontratat e tjera të lidhura (me shoqërinë "Kristi Konstruktion 2003"), kanë pasur pak a shumë të njëjtin çmim, ku me konkretisht subjekti ka bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. ***** kol, datë 19.10.2016, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 60.12m², në rrugën “Plazh”, Durrës. Blerës: shtetasi C.D. Shitës: shoqëria “Kristi Konstruksion 2003” sh.p.k. Çmimi: 17.000 euro.

→ Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

Apartamenti me sip. 84.36m² në Plazh, Durrës, është blerë në shumën 2.300.000 lekë në vitin 2016 dhe si burim financiar i kësaj shume është deklaruar: 15.000 euro nga shitja e automjetit me targë AA***KR, në pronësi të nënës së subjektit sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016, si dhe kursimet familjare. Ka deklaruar mobilimin për këtë apartament e kanë kryer me mobiljet e apartamentit të shitur në Rrëshen në vitin 2017, i cili është blerë i mobiluar.

53. Lidhur me burimin financiar të krijimit të këtij apartamenti në shumën 2.300.000 lekë, subjekti ka paraqitur dokumente justifikuese për pjesën që i takon kursimeve të tij dhe prindërve, pra për shumën rreth 300.000 lekë,

ndërsa:

Për sa i përket të ardhurave të realizuara nga shitja e automjeti me targë AA***KR, në vitin 2016, Trupa e Vlerësimit vëren se pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference (detyruese) për shitblerje automjetesh, shitja e automjetit me targë AA***KR, ka gjeneruar të ardhura për subjektin, për të cilat duhej të ishin paguar detyrimet përkatëse tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me, detyrimin tatimor mbi diferencën e shumës prej 12.000 euro të ardhura të përfutuara nga shitja e automjetit me targë AA***KR, rezultojnë se **subjekti i vlerësimit nuk e ka kryer pagesën sipas legjislacionit tatimor në fuqi.** (Në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 (i ndryshuar), nen 2.3 pika 2.3.9 “...Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g) Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart... ”.)

Sa sipër:

54. Me postën elektronike të datës 09.05.2024 dhe 26.09.2024, subjekti është pyetur nëse është kryer pagesa e detyrimit të tatimor sipas legjislacionit në fuqi, në të cilën subjekti sqaroi se:

“...Në lidhje me këtë fakt u paraqita pranë organeve tatimore dhe nga sistemi i DPT kam printuar Urdhër Pagesën për këtë detyrim të cilin e kam derdhur në Credins Bank. Sqaroj se pagesa për automjetin me targë AA***KR është 473.971 lekë (bashkëlidhur gjeni Urdhër Pagesën si dhe Mandatin e Pagesës. ..). ”

55. Trupa e vlerësimit, duke mbajtur parasysh: deklarin e subjektit të vlerësimit në deklaratën e kontrollit të pasurisë; raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga Trupa e Vlerësimit; shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguar në përgjigje të barrës së provës arsyeton si vijon:

- ✓ **Deklarimi i subjektit është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm.**

Pasuri e tjetërsuar Nr. 3

56. Apartament me sip. 42m², pallati **, apartamenti **, shkalla *, Kati *, Rrëshen, Mirditë. Vlera 1.281.000 lekë. Zotërimi 25%. Burimi: Legalizuar. Shitur me kontratë nr. **** rep, nr. **** kol, datë 20.11.2008.

- ✓ **Trajtuar me sipër.**

Pasuri e tjetërsuar Nr.4

57. Autoveturë Benz, blerë me kontratë nr. **** rep, nr. *** kol, datë 22.12.2003, në shumën 250.000 lekë. Burimi: Kursime familjare. Shitur me kontratë nr. *** rep. nr. *** kol, datë 17.10.2007, në shumën 250.000 lekë. Zotërimi 100%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.12.2003, për automjet Mercedes Benz, me targa të huaja, me nr. shasie WDB*****. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: A. R. Çmimi: 250.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.10.2007, për automjet Mercedes Benz (me targa TR 55..., nr. shasie WDB*****). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: M. T. Çmimi: 250.000 lekë.

58. **DPSHTRR**, me shkresën nr. **** prot, datë 11.08.2023, nuk e konfirmon këtë automjet të ketë qenë apo të jetë i regjistruar në emër të Armir Gjokolaj. Me postën elektronike të datës 18.10.2023, kërkesës për të verifikuar automjetin, referuar nr. të shasisë sipas kontratës, DPSHTRR informon se për sa i përket numrit të identifikimit WDB*****, nuk rezulton që këtë automjet ta ketë pasur në pronësi Armir Gjokolaj.

Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:

- Kërkesë datë 30.10.2023, nga Armir Gjokolaj, drejtuar DPSHTRR, ku kërkon konfirmimin e pronësise së mjetit me targa TR *** J.
- Vërtetim dhe verifikim dokumentacioni nr. ***** rep, nr. ****, lëshuar nga noteri S. Sh, për kontratën shitblerje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 17.10.2007, për automjet Mercedes Benz (me

targa TR ***J, nr. shasie WDB*****). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: M. T. Çmimi: 250.000 lekë.

→ **Konstatohet se:** Automjeti Mercedes Benz, është blerë në vitin 2003 në shumën 250.000 lekë dhe shitur në vitin 2007 po në shumën 250.000 lekë. Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumente justifikuese për blerjen dhe pronësinë e automjetit me targë TR *** J.

Pasuri e tjetërsuar Nr. 5

59. Autoveturë Benz, blerë me kontratë nr. ***** rep, nr. *** kol, datë 13.02.2012, në shumën 1.500 euro. Burimi: Kursime familjare. Shitur me kontratë nr. ***** rep. nr. ***** kol, datë 30.01.2014, në shumën 500.000 lekë. Zoterimi 100%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. *** kol, datë 13.02.2012, për automjet Mercedes Benz. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: B. M. Çmimi: 1.500 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.01.2014, për automjet Mercedes Benz (targa AA *** CN). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: R. Sh. Çmimi: 500.000 lekë.

60. **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA *** CN. **Bashkëlidhur:**

- Kontratë shitblerje nr. *****rep, nr. *****kol, datë 13.02.2012, për automjet Mercedes Benz. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: B. M. Cmimi: 1.500 euro.
- Deklaratë doganore datë 16.12.2012, për automjet Mercedes Benz (në pronësi të Armir Gjokolaj). Vlera e mjetit: 1.500 euro. Pagesa e zhdoganimit: 51.379 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.01.2014, për automjet Mercedes Benz (targa AA *** CN). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: R. Sh. Çmimi: 500.000 lekë.

Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:

- Shpjegime me shkrim, ku lidhur me shitjen e këtij automjeti (500.000 lekë), më shtrenjtë se çmimi i blerjes (1.500 euro² ~ 208.815 lekë), subjekti shpjegoi se automjeti ishte me targa austriake dhe kishte pasur probleme me motorrin. Automjeti u zhdoganua, riparua dhe u mbajt një periudhë kohë nga subjekti pastaj u shit me vlerën 500.000 lekë. Pagesat për blerje e shitje të automjetit janë berë jashtë zyrave noteriale. Me blerësin dhe shitësin e këtij automjeti nuk ka asnjë marrëdhënie apo njohje.

²Çmimi 1.500 euro, vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën e nënshkrimit të kontratës, 1 euro=139.21 lekë.

61. Me postën elektronike të datës 09.05.2024 dhe 26.09.2024, subjekti është pyetur nëse është kryer pagesa e detyrimit e tatimor sipas legjislacionit në fuqi, në të cilën subjekti sqaroi se:

*“...Në lidhje me këtë fakt u paraqita pranë organeve tatimore dhe nga sistemi i DPT kam printuar Urdhër Pagesën për këtë detyrim të cilin e kam derdhur në Credins Bank. Sqaroi se pagesa për automjetin me targë AA***CN është 84.048 lekë (bashkëlidhur gjeni Urdhër Pagesën si dhe Mandatin e Pagesës. ...).”*

→ **Konstatohet se:** mjeti me targë AA***CN, është blerë në vitin 2012 në shumën 1.500 euro dhe shitur në vitin 2014 në shumën 500.000 lekë. Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumente justifikuese.

Pasuri e tjetërsuar Nr. 6

62. Autoveturë Benz, blerë me kontratë nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 25.6.2014, në shumën 250.000 lekë. Burimi: Kursime familjare. Shitur me kontratë nr. rep, nr. ***** kol, datë 21.07.2015, në shumën 3.000 euro. Zotërimi 100%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 25.06.2014, për automjet Daimler Chrysler. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: M. T. Çmimi: 250.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. rep, nr. ***** kol, datë 21.07.2015, për automjet Daimler Chrysler (targa AA *** IT). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Z. M. Çmimi: 3.000 euro.

63. DPSHTRR, me shkresën nr. *****prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA *** IT. **Bashkëlidhur:**

- Faturë tatimore shitje nr. **, datë 15.04.2014, për automjet Daimler Chrysler. Shitës: L. N. Blerës: M. T. Çmimi: 396.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. 1134 kol, datë 25.06.2014, për automjet Daimler Chrysler. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: M. T. Çmimi: 250.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 21.07.2015, për automjet Daimler Chrysler (targa AA *** IT). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Z. M. Çmimi: 3.000 euro.

Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:

Shpjegime me shkrim ku lidhur me blerjen e këtij automjeti më lirë (250.000 lekë), dy muaj pas blerjes së saj nga pronari i mëparshëm (396.000 lekë) dhe më pas shitjen e këtij automjeti me shtrenjtte (3.000 euro) se çmimi i blerjes, subjekti shpjegoi se automjeti ishte me targa (të huaja BZ *** EJ), i zhdoganuar dhe ndodhej tek pika e shitjes në fshatin Tapizë (Kruje), pasi ishte përplasur në pjesën e pasme. Kjo pikë shitje (varreza makinash) administrohej nga vëllezërit T.... Automjeti u riparua dhe u mbajt një periudhë kohë nga unë, pastaj u shit. Pagesat për blerjen dhe shitjen e automjetit janë bërë

jashtë zyra ve noteriale. Me blerësin dhe shitësin e këtij automjeti subjekti deklaron se nuk ka asnjë marrëdhënie apo njohje.

✓ **Konfirmohen nga DPSHTRR kontratat e shitblerjes.**

Pasuri e tjetërsuar Nr. 7

64. Autoveturë Volkswagen, blerë me kontratë nr. ***** rep, nr. *** kol, datë 13.06.2016, në shumën 1.500 euro. Burimi: Kursime familjare. Shitur me kontratë nr. ***** rep., nr. *** kol, datë 22.11.2016, në shumën 6.500 euro. Zotërimi 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 13.06.2016, për automjet Volkswagen Passat. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: A. H. Çmimi: 1.500 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.11.2016, për automjet Volkswagen Passat (targa AA *** LM). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: A. Dh. Çmimi: 6.500 euro.

65. **DPSHTRR**, me shkresën nr. ***** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA *** LM. **Bashkëlidhur:**

- Deklaratë doganore datë 19.03.2015, për zhdoganimin e automjet Volkswagen Passat, me importues S. P. Vlera e automjetit sipas deklaratës: 250.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. *** kol, datë 30.03.2015, për automjet Volkswagen Passat. Blerës: A. H. Shitës: S. P. Çmimi: 4.000 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 13.06.2016, për automjet Volkswagen Passat. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: A. H. Çmimi: 1.500 euro.
- Kontrate shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 22.11.2016, për automjet Volkswagen Passat (targa AA *** LM). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: A. Dh. Çmimi: 6.500 euro.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Shpjegime me shkrim ku lidhur me blerjen e këtij automjeti me lirë (1.500 euro) 1 vit pas blerjes së saj nga pronari i mëparshëm (4.000 euro) dhe me pas shitjen e këtij automjeti më shtrenjtë (6.500 euro) se çmimi i blerjes, subjekti shpjegoi se automjeti kishte probleme me injektorët dhe me katalizatorët, nuk ecte me shumë se 80-90 km/orë, prandaj u ble nga subjekti me 1.500 euro. Automjeti u riparua dhe u mbajt një periudhë kohe dhe pastaj u shit. Pagesat për blerje e shitje të automjetit janë bërë jashtë zyra ve noteriale. Me shitësin ka njohje pasi janë koleg pune por nuk kanë pas marrëdhënie për shkak të punës, ndërsa me blerësen deklaron se nuk ka asnjë marrëdhënie apo njohje.

66. Me postën elektronike të datës 14.05.2024, subjekti u pyet në lidhje me shpenzimet e kryera për mjetin me targë AA***LM, si nëse nga ana e tij janë paguar detyrimet tatimore, subjekti i vlerësimit deklaroi në prapësime si më poshtë vijon:

*“...Kam depozituar më datë 15.05.2024, nëpërmjet emailit shkresën e ardhur nga servisi i shtetasit P. P, të datës 13.05.2024, ku sqaron se ka riparuar injektorët/marmitën në vlerën 49.000 lekë si dhe shërbime të tjera të cilat janë të listuara nga servisi i shtetasit P.P. Në lidhje me mospagimin e detyrimeve tatimore nga ana ime u paraqita pranë organeve tatimore dhe nga sistemi i DPT kam printuar Urdhër Pagesën për këtë detyrim të cilin e kam derdhur në Credins Bank. Sqaroj se pagesa për automjetin me targë AA***ML është 177.104 lekë (bashkëlidhur gjeni Urdhër Pagesën si dhe Mandatin e Pagesës. ..).”*

→ **Konstatohet se:** Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumente justifikuese.

Pasuri Nr. 8

67. Autoveturë Volkswagen, blerë me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 20.10.2016, në shumën 3.000 euro. Burimi: Kursime familjare. Shitur me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 06.12.2019, në shumën 50.000 lekë. Zotërimi 100%.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 20.10.2016, për automjet Volkswagen Passat. Bleres: Armir Gjokolaj. Shites: B. M. Cmimi: 3.000 euro.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 06.11.2019, për automjet Volkswagen Passat (targa AA***OU). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Tereze Gjokolaj. Cmimi: 50.000 lekë.

68. DPSHTRR, me shkresën nr. ***** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA***OU. **Bashkëlidhur:**

- Faturë blerje datë 11.10.2016 (në gjermanisht, e përkthyer në shqip), për automjet Volkswagen Passat, vit prodhimi 2010, me blerës B. M.
- Deklaratë doganore, datë 19.10.2016, për automjet Volkswagen Passat, vit prodhimi 2010, me marrës B. M.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. ** kol, datë 20.10.2016, për automjet Volkswagen Passat, vit prodhimi 2010. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: B. M. Cmimi: 3.000 euro.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 06.11.2019, për automjet Volkswagen Passat, vit prodhimi 2010 targa AA ***OU. Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Tereze Gjokolaj. Çmimi: 50.000 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen dhe dokumentacionin e ardhur nga DPSHRR.**

69. Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë, bënë me dije se:

Për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj dhe personat e lidhur, nuk rezultojnë veprime/akte noteriale të kryera përveç atyre që ka deklaruar subjekti i vlerësimit.

✓ **Përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e dorëzuar nga Regjistri Noterial.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

- Të ardhura si punonjës pranë DVP Lezhë, në shumën 527.964 lekë.
- Të ardhura si punonjës prane DVP Kukës, në shumën 352.053 lekë.
- Të ardhura si punonjës pranë DVP Shkodër, në shumën 704.240 lekë.
- Të ardhura nga paga si punonjës i Policisë së Shtetit në RFZ, nga data 01.10.2004 - 02.03.2023, në shumën 17.507.094 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit 25% me kontratë nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 20.11.2008 (shitur 1.281.000 lekë), në shumën 320.250 lekë.
- Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** datë 14.12.2022, nëpërmjet Përmbaruesit Gjyqësor, kaluar në llogarinë e BKT, në shumën 4.301.534 lekë.
- Ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. *****, dt. 23.9.2010 (kompensim për burgim të padrejtë). Shuma 97.000 lekë.
- Shitja e automjetit Benz, me kontrate nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 30.01.2014 (blerë me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.01.2014, blerë 1.500 euro, shitur 500.000 leke.
- Shitja e automjetit Benz, me kontratë nr. ***** kol, datë 21.07.2015 (blerë me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 25.06.2014), blerë 250.000 lekë, shitur 3.000 euro.
- Shitja e automjetit Volkswagen, me kontrate nr. 13467 rep, nr. 8515 kol, datë 22.11.2016 (blerë me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 13.06.2016), blerë 1.500 euro, shitur 6.500 euro.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme për të ardhurat e Armir Gjikota pranë DVP Lezhë, për periudhën nëntor 2000 - mars 2003, në shumën neto 527.916 lekë.
- Vërtetim page për të ardhurat e Armir Gjikota prane DPV Shkodër, për periudhën mars 2003 - qershor 2004 dhe janar 2005 - mars 2005, në shumën neto 704.240 lekë.
- Vërtetim page për të ardhurat e Armir Gjikota pranë DVP Kukës, për vitin 2004, në shumën neto 352.053 lekë.
- Vërtetim për produktet bankare të klientit në RFZ Bank, për periudhën 2005 – 2023.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *****kol, datë 20.11.2008, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 42m2, me nr. pasurie *****, Mirditë. Shitës: Mara, Pal, Tereze dhe Armir Gjokolaj. Blerës: Gj. L. Çmimi: 1.281.000 lekë, i likujduar.
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. regjistri *****, datë 05.11.2012, i cili i ka pranuar lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. ***** Regjistri Themeltar, nr. ***** Vendimi, datë 14.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas të cilit është detyruar pala

paditëse, shoqëria “INSIG”, të dëmshpërblejë paditësin Armir Gjokolaj si dhe personat e tretë (ndërhyrës kryesorë), Mara, Pal dhe Tereze Gjikota, për dëmin pasuror dhe jo-pasuror shkaktuar nga aksidenti i datës 27.03.2009, në shumën totale 9.722.738 lekë e ndarë përkatësisht: Armir Gjokolaj në shumën 1.722.738 lekë si dëm pasuror dhe 2.000.000 lekë si dëm jo pasuror; Mara, Pal dhe Tereze Gjikota secili në shumën 2.000.000 lekë si dëm jo-pasuror. + Kërkesë për transaksion nga BKT, datë 14.12.2012, nga urdhëruesi J. P PF, për shumën 10.301.534 lekë në llogarinë e përfituesit, Armir Gjokolaj, sipas vendimit gjyqësor nr. 1222, datë 14.02.2012.

- Vendim nr. 828, datë 23.09.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i cili ka vendosur detyrimin e Ministrisë së Financave të kompensojë paditësin Armir Gjokolaj për burgim të padrejtë në shumën 97.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 13.02.2012, për automjet Mercedes Benz. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: B. M. Çmimi: 1.500 euro. + Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 30.01.2014, për automjet Mercedes Benz (targa AA **** CN). Shites: Armir Gjokolaj. Blerës: R. Sh. Çmimi: 500.000 lekë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 25.06.2014, për automjet Daimler Chrysler. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: M. T. Çmimi: 250.000 lekë. + Kontratë shitblerje nr. rep, nr. **** kol, datë 21.07.2015, për automjet Daimler Chrysler (targa AA *** IT). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Z. M. Çmimi: 3.000 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. **** kol, datë 13.06.2016, për automjet Volkswagen Passat. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: A. H. Çmimi: 1.500 euro. + Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.11.2016, për automjet Volkswagen Passat (targa AA *** LM). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: A. Dh. Çmimi: 6.500 euro.

70. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, për periudhën 04.05.2005 - 03.03.2023, ka përfituar të ardhura nga pagat, dietat dhe shpërblimet në shumën 16.745.102 lekë. Gjithashtu, konfirmon edhe se në datë 25.11.2021, 23.12.2021 dhe 08.03.2022, nëpërmjet tre pagesave Armir Gjokolaj ka përfituar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve, një shumë totale prej 188.847 lekë.

71. BKT, me shkresën nr. 51/3 prot, datë 14.08.2023, konfirmon se në datë 19.07.2013, në llogarinë e Armir Gjokolaj, nga PF J. P është transferuar shuma 83.300 lekë, me përshkrimin “likuidim total vendimi gjyqësor nr. ***, datë 23.9.2010”.

72. ISSH, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj, për periudhën dhjetor 2012 - qershor 2023, rezulton i punësuar pranë Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale; Drejtoria e Policisë së Qarkut; Komisariati i Policisë Shkodër; Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale; Departamenti për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda; Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër; Drejtoria Rajonale e Policisë së Kufirit dhe Migracionit; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Shpjegime me shkrim ku për shumat e kredituara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve, shpjegoi se ato kanë qenë të ardhura nga raporte mjeksore.
- Kërkesë, datë 01.11.2023, nga Armir Gjokolaj, drejtuar DRSSH, ku kërkon pagesat kryera nga ISSH në favor të tij në vitin 2021 dhe 2022.
- Email datë 01.11.2023, dërguar nga Armir Gjokolaj, drejtuar Policisë së Shtetit, ku kërkon informacion për shumat e përfituara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve.
- ✓ **Të ardhurat neto të subjektit nga pagat, dietat, shpërblimet, raportet dhe vendimi gjyqësor në periudhën nëntor 2000 - mars 2023, janë në shumën rreth 18.601.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti, prindërit e tij dhe gjyshja (nga sa trajtuar më lart) kanë përfituar në total të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 42m² në Mirdite në vitin 2008, shumën 1.281.000 lekë (blerë nga babai në vitin 1993 në shumën 130.000 lekë).**
- ✓ **Subjekti, prindërit e tij dhe gjyshja (nga sa trajtuar më lart) kanë përfituar në total nga vendimi gjyqësor për aksidentin në vitin 2012, shumën 10.301.534 lekë, kaluar nëpërmjet llogarisë në BKT.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022

- Apartament në rrugën “Ali Demi”, ap. **, H. **, Tiranë (pagë e deklaruesit, pensioni babait dhe nënës): ujë në shumën 46.080 lekë; drita në shumën 145.877 lekë; internet, në shumën 26.280 lekë.
- Apartament në rrugën “Plazh-Plepa”, Golem, ap. **, H. **, Durrës (pagesë e deklaruesit, pensioni babait dhe nënës: ujë në shumën 12.096 lekë; drita në shumën 18.878 lekë.
- Telefon me nr. 069*****, në shumën 8.993 lekë.
- Telefon me nr. 069*****, në shumën 19.200 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Dy 2) libreza për pagesat mujore të faturave të energjisë për vitin 2022.
- Dy (2) libreza për pagesat mujore të faturave të ujit të pijshëm për vitin 2022.
- Formular regjistrimi i klientit pranë kompanisë ABISSNET, datë 09.05.2022, për pagesë mujore 2.190 lekë, ku është kryer parapagim në shumën 26.280 lekë.
- Përmbledhje pagesë faturash telefonike për vitin 2022, në emër të Armir Gjokolaj, Komisariati i Policisë Krujë, në shumën 9.693 lekë.
- Përmbledhje pagesë faturash telefonike për vitin 2022, në emër të Armir Gjokolaj, në shumën 19.200 lekë.

73. **FSHU**, me shkresën nr. ***** prot, datë 10.08.2023, konfirmon se me emrin Armir Pal Gjokolaj, për abonentin me nr. TR*****, me adresë Ali Demi, Tiranë, për vitin 2022 janë paguar për

energji elektrike në total 145.673 lekë, ndërsa për abonentin me nr. DU*****, me adresë Durres/Kavajë, për vitin 2022 janë paguar për energji elektrike në total 23.495 lekë.

74. **UKT**, me shkresën nr. **** prot, datë 21.08.2023, konfirmon se në emër të Armir Pal Gjokolaj, rezulton kontrata nr. *****, për objektin me adresë: Rr. “Ali Demi”, me status Aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në muajin qershor 2023.
75. **UKD**, me shkresën nr. **** prot, datë 16.08.2023, konfirmon se në emër të Armir Gjokolaj, rezulton kontrata nr. *****, me adresë: Lagjja nr. **, Durrës. Për vitin 2022, për konsumimin e ujit janë paguar në total 11.914 lekë.
76. **13 Shogërite Rajonale te Ujësjetllës - Kanalizime**, me shkresat nr. **** - **** prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
77. **One Albania, sha**, me shkresën nr. **** prot, datë 25.08.2023, konfirmon se Pal Gjokolaj, ka të regjistruar numrin +35568***** dhe për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ka paguar për shërbimin në shumën 2.100 lekë.
78. **Vodafone Albania**, me shkresën nr. *** prot, datë 12.01.2024, ka bashkëlidhur CD.
79. **Albanian Satellite Communications**, me shkresën nr. **** prot, datë 24.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj dhe personat e lidhur me të, nuk kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.
80. **ABISSNET**, me shkresën nr. v-prot, datë 14.08.2023, konfirmon se Armir Pal Gjokolaj, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, ka qenë palë në kontratën e shërbimit të internetit datë 09.05.2022 dhe faturimi total i pagesave për këtë kontratë është 59.560 lekë (sipas kartelës së klientit janë paguar në total 29.270 lekë dhe jo 59.560 lekë).
81. **DIGICOM**, me shkresën nr. **** prot, datë 09.08.2023, konfirmon se Armir Gjokolaj dhe personat e lidhur me të, nuk kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri.

→ **Shpenzimet për energji elektrike, ujë, internet dhe telefon, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, kanë qenë në shumën rreth 296.800 lekë.**

✓ **Nga të dhënat e analizës financiare ka rezultuar se subjekti ka pas të ardhura për mbulimin e shpenzimeve.**

✚ **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara – Periudha 01.01.2020 – 31.12.2022.**

- Pushime në Mal të Zi më datë 18.09.2020, për 2 ditë. Shuma 120 euro.
- Së bashku me kunatin kemi dërguar motrën me fëmijët për në aeroportin e Prishtinës në Kosovë, më datë 12.10.2020. shuma 0 lekë.
- Pushime në SHBA, Detroit, më datë 07.06.2022, për 13 ditë. Ushqim dhe fjetje tek familja e vajzës së xhaxhit Dh. Gj, agjencia American Travel. Shuma 1.200 USD.
- Pushime në Turqi me datës 05.09.2022, për 6 ditë, agjencia Golden Travel. Shuma 788 euro.
- Darkë në Mal të Zi më datë 23.09.2022. Shuma 35 euro.
- Pushim në Emiratet Arabe, Dubai, më datë 04.11.2022, për 5 ditë, agjencia Golden Travel, shuma 1.155 euro dhe 200 euro jashtë ofertës së agjencisë. Shuma 1.355 euro.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Faturë datë 07.06.2022, për fluturim me kompaninë American Travel, për Armir Gjokolaj, në shumën 1.200 USD.
- Faturë për udhëtim drejtë Turqisë, datë 01.09.2022, për Armir Gjokolaj, në shumën 788 euro.
- Rezervim fluturimi dhe faturë për udhëtim drejtë Emirateve të Bashkuara Arabe, datë 04.11.2022, në shumën 660 euro.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Deklaratë të thjeshtë, datë 19.10.2023, me emin I. G, ku deklarohet se djali i xhaxhit të saj, Armir Gjokolaj, ka shkuar me pushime në SHBA më datë 07.06.2022 dhe ka qëndruar 13 ditë. Të gjitha shpenzimet e djalit të xhaxhait në SHBA janë mbuluar nga ajo.
 - Kopje pasaporte e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në emër të I. K. G.
 - Kthim përgjigje nr. **** Prot, datë 30.10.2023, nga DVP Tiranë, drejtuar Armir Gjokolaj për hyrje-daljet e tij nga sistemi TIMS, ku evidentohet se për periudhën 2020 - 2022, ka kryer 6 dalje dhe 5 hyrje.
 - Kthim përgjigje nr. **** Prot, datë 20.10.2023, nga DVP Tiranë, drejtuar Armir Gjokolaj për hyrje-daljet e Ch. Gjokolaj nga sistemi TIMS, ku evidentohet se për periudhën 2020 - 2022, ka kryer 4 dalje dhe 3 hyrje.
 - Kthim përgjigje nr. **** Prot, datë 02.11.2023, nga DVP Tiranë, drejtuar Armir Gjokolaj për hyrje-daljet e Pal Gjokolaj nga sistemi TIMS, ku informon se për periudhën nga viti 2020 në vazhdim nuk ka hyrje-dalje.
 - Kthim përgjigje nr. **** Prot, datë 01.11.2023, nga DVP Tiranë, drejtuar Armir Gjokolaj për hyrje-daljet e Tereze Gjokolaj nga sistemi TIMS, ku informon se për periudhën nga viti 2020 në vazhdim nuk ka hyrje-dalje.
- ✓ **Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën në fjalë kanë qenë në shumën rreth 2.300 euro dhe 1.200 USD, konvertuar rreth 391.000 lekë.**
- ✓ **Nga të dhënat e analizës financiare ka rezultuar se subjekti ka pas të ardhura për mbulimin e shpenzimeve.**

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR (BABAI) - PAL GJIKOLAJ DEKLARIMI I PASURIVE

82. Sipërfaqe truall arë e trashëguar në Kurbnesh, Mirditë, sip. 623m², 723m² dhe 328m², zk. 3987. Vlera 0 lekë. Zoterimi 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 11.12.2007, për pasurinë e llojit arë, me sip. 328m², me nr. pasurie ***, në Mirditë, Kurbnesh, regjistruar në emër të Pal Gjokolaj, familjar.
- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 11.12.2007, për pasurinë e llojit arë, me sip. 723m², me nr. pasurie ***, në Mirditë, Kurbnesh, regjistruar në emër të Pal Gjokolaj, familjar.

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. *****, datë 11.12.2007, për pasurinë e llojit arë, me sip. 623m², me nr. pasurie ***, në Mirditë, Kurbnesh, regjistruar në emër të Pal Gjokolaj, familjar.

83. ASHK Rrëshen, me shkresën nr. ***** prot, datë 02.10.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Shpjegime me shkrim ku sqaroi se në këto pasuri nuk ka investime dhe nuk shfrytëzohen.
- AMTP nr. *****, datë 20.09.2002, në emër të familjes së Pal Gjokolaj, për tokë arë me sip. 623m², 723m² dhe 328m². + Hartat treguese të regjistrimit.

→ **Me inventarin e datës 15.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Ortofoto satelitore e tri parcelave të tokës në Kurbnesh.

→ **Konstatohet se:** Pasuritë tokë arë me sip. 623m², 723m² dhe 328m² në Mirditë, Kurbnesh janë përfutur nga babai i subjektit me AMTP.

✓ **Konfirmohet deklarimi me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur. ASHK nuk i konfirmon të regjistruara pasuritë në emër të babait, Pal Gjokolaj.**

84. Llogari bankare OTP Bank e krijuar nga shitja e apartamentit nr. *****, datë 28.12.2017, me vlerë 3.486.000 lekë dhe 500.000 lekë kursime familjare, konvertuar me kurs banke 133,5 lekë/euro. Vlera 29.917 euro. Zoterimi 50%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Shpjegime mbi krijimin dhe veprimet e kryera në llogari në emër të Pal dhe Tereze Gjokolaj në OTP Bank, ku sqarohet se burimi financiar i depozitës ka qenë shitja e apartamentit me kontratë nr. ***** rep, datë 28.12.2017 dhe një shumë prej 500.000 lekë nga kursimet personale.
- Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, datë 20.02.2023, për llogari në emër të Pal dhe Tereze Gjokolaj, ku evidentohet se çelja e depozitës prej 29.917 euro është bërë datë 03.01.2018.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. *** kol, datë 27.12.2017, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 83m², me nr. pasurie *****, Mirditë. Shitës: Pal, Tereze dhe B. Gj, D. D e M. G. Blerës: P. Gj. Çmimi: 3.486.000 lekë, i likuiduar në llogarinë e noterit, V. B.

85. OTP Bank, me shkresën nr. ***** prot, datë 04.08.2023, konfirmon se Pal dhe Tereze Gjokolaj, në datë 10.03.2023, kanë llogari rrjedhëse me gjendje 29.917 euro. Në llogarinë e Pal Gjokolaj evidentohet se në datë 28.12.2017, Vitore Dedaj ka transferuar një shumë prej 3.486.000 lekë, me përshkrimin “legalizim noterial nr. ***** rep, datë 28.12.2017, kalim për blerje apartamenti nr. 8/45+1-9”. Në datë 03.01.2018, Pal Gjokolaj ka depozituar cash edhe një shumë prej 500.000 lekë dhe nga kjo llogari ka transferuar në llogarinë në euro një shumë prej 3.994.000 lekë, duke i konvertuar në shumën 29.917 euro.

86. **ASHK Rreshen**, me shkresën nr. **** prot, datë 02.10.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Deklaratë e thjeshtë, datë 30.10.2023, nga Pal Gjokolaj, i cili deklaron se në apartamentin e shitur në vitin 2017, ka jetuar nga viti 1971, deri në momentin e shitjes. Më datë 17.08.1993, me mandat arketimi nr. 376, është blerë apartamenti në shumën 7.120 lekë nga Pal Gjokolaj. Më datë 29.08.1993 u bënë privatizimet e banesave dhe me një vertetim të Hipotekës së Rrethit Mirditë është bërë regjistrimi i këtij apartamenti me nr. 515 në emër të Pal Gjokolaj. Sipas gjëndjes civile, në familjen e tij nga viti 1971 dhe deri më datë 29.08.1993, kur u bë privatizimi, kanë qenë Pal Gjokolaj, nëna e tij, Mara Gjokolaj dhe b/shortja Tereze Gjokolaj. Më datë 27.12.2017, në kohën e privatizimit të apartamentit ka qenë edhe nëna, e cila është ndarë nga jeta, nga ana e noteres u thirrën tre fëmijët e tjerë për të firmosur kontratën. Për mobilimin e këtij apartamenti, subjekti shpjegoi se apartamenti është mobiluar në vitin 1973 dhe gjatë viteve mobiljet e vjetra janë zëvendësuar me të reja.
- Mandat arkëtimi nr. 376, datë 17.08.1993, ku Pal Gjokolaj ka arkëtuar shumën 7.120 lekë, për blerje apartamenti.
- Vërtetim datë 23.08.1993, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Mirditë, ku vërteton se është regjistruar në emër të Pal Gjokolaj, me nr. 515, në regjistrin e apartamenteve.
- Legalizim noterial nr. *** rep, nr. 28.12.2017, për certifikatë pronësie nr. *****, datë 28.12.2017, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 83m², me nr. pasurie ****, Mirditë, regjistruar në emër të P. Gj.

→ **Konstatohet se:** Depozita në shumën 29.917 euro është çelur në datë 03.01.2018, me burim shitjen e apartamentit në Rrëshen me kontratë nr. **** rep, datë 28.12.2017, si dhe një shumë prej 500.000 lekë nga kursimet personale. Apartamenti në Rrëshen është blerë nga babai në vitin 1993, në shumën 7.120 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacioni e paraqitur dhe pergjigjen e OTP Bank. Burimi financiar i kësaj depozite ka qenë shitja e apartamentit me sip. 83m² në qytetin e Rrëshenit në vitin 2017, në shumën 3.486.000 lekë, dhe një shumë prej 500.000 lekë, depozituar nga Pal Gjokolaj (të ardhurat e babait janë trajtuar më poshtë). Apartamenti në qytetin e Rrëshenit me sip. 83m², është blerë në vitin 1993 me çmimin 7.120 lekë.**
- ✓ **Nga të dhënat e analizës financiare ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të për pasurinë 500.000 lekë, kanë pas të ardhura për krijimin e kësaj vlere.**

87. Bono Thesari e krijuar në Raiffeisen Bank nga kursime familjare, nga b/shortja në datë 13.12.2007, në shumën 1.071.940 lekë. Interesat e fituara gjatë viteve 2007 deri në 24.12.2013, janë shtuar në llogari duke arritur vlerën 2.608.480 lekë dhe po në datën 24.12.2013 është transferuar në llogarinë e Pal Gjokolaj. Më datë 31.12.2014, vlera 998.900 lekë është tërhequr për mobilimin e shtëpisë në Tiranë. Interesat nuk janë tërhequr por janë shtuar në vlerë dhe në datën 03.06.2022 vlera e saj është 1.709.393 lekë. Balanca në 31.01.2023 është; 1.709.393 lekë; 20.299 lekë. Zoterimi 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Shpjegime mbi krijimin dhe veprimet në llogarinë në emër të Pal Gjokolaj në Raiffeisen Bank, ku sqarojnë se shuma 2.608.480 lekë është kaluar në llogari nga b/shortja, Tereze Gjokolaj. Nga kjo shumë, në datë 31.12.2014 kanë tërhequr 998.900 lekë për mobilimin e shtëpisë, ndërsa, shuma e mbetur prej 1.663.988 lekë është riinvestuar.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Pal Gjokolaj, ku evidentohet se në datë 24.12.2013 është investuar në Fondin Prestigj një shumë prej 2.608.480 lekë.

88. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ***** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se Pal Gjokolaj, në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje 20.249 lekë. Raiffeisen Bank, konfirmon se në datë 13.12.2007, Tereze Gjokolaj ka çelur një depozitë në shumën 1.071.940 lekë, e cila është maturuar në datë 22.12.2011, duke shkuar në vlerën 1.301.330 lekë. Në të njejtën datë, rezulton se Tereze Gjokolaj ka derdhur në llogari një shumë prej 800.000 lekë dhe ka çelur një depozitë të re në shumën 2.101.300 lekë. Kjo depozitë është maturuar në datë 21.12.2012, në shumën 2.211.288 lekë. Në datën 24.12.2012, Tereze Gjokolaj ka derdhur edhe një shumë prej 300.000 lekë dhe ka çelur një depozitë të re në shumën 2.511.300 lekë. Në datë 24.12.2013, pas maturimit, depozitën prej 2.511.300 lekë dhe interesat në shumën 97.187 lekë (në total 2.608.480 lekë), Tereze Gjokolaj i ka transferuar në llogarinë e Pal Gjokolaj, shumë e cila, më pas, nga Pal Gjokolaj është kaluar si Fond Investimi në Raiffeisen Prestigj. Nga ky Fond, në datë 27.06.2014 është tërhequr një shumë prej 174.493 lekë; në datë 31.12.2014, një shumë prej 998.900 lekë me përshkrimin “terheqje per mobilim shtëpie” dhe në datë 08.03.2016 është mbyllur investimi dhe është tërhequr edhe shuma prej 1.663.988 lekë. Në datë 17.03.2016, Pal Gjokolaj ka blerë Bono Thesari në shumën 1.680.000 lekë. Raiffeisen Bank, me postën elektronike të datës 13.10.2023, konfirmon se investimi në Bono Thesari ka vazhduar deri në datë 23.05.2017 kur janë maturuar. Në datë 06.04.2022, Pal Gjokolaj ka investuar në Obligacione në shumën 1.700.000 lekë. Data e maturimit të Obligacioneve është data 06.04.2024.

Raiffeisen Bank konfirmon gjithashtu se, në datë 21.10.2010, në llogarinë e Armir Gjokolaj nga kompania INSIG janë kredituar 652.800 lekë, me përshkrimin “pagesë dëmshpërblimi nga TPC Auto DE *** TB”. Nga kjo llogari, në datë 25.10.2010 janë tërhequr cash 500.000 lekë dhe në datë 26.10.2010, janë tërhequr cash 150.000 lekë.

89. Raiffeisen Invest, me shkresën nr. ***** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Pal Gjokolaj ka pasur një marrëdhënie juridike me Raiffeisen Invest duke investuar në Fondin Prestigj, që ka filluar në datë 24.12.2013 dhe ka përfunduar në datë 04.03.2016. Pal Gjokolaj ka investuar 2.608.479 lekë. Nga ky investim ka tërhequr: 174.893 lekë në datë 24.06.2014; 998.846 lekë në datë 24.12.2014 dhe; 1.664.588 lekë në datë 04.03.2016. Fitimi nga investimi në total ka qenë në shumën 267.234 lekë.

→ **Me inventarin e datës 03.11.2023, subjekti paraqiti:**

Shpjegime me shkrim, ku lidhur me deklarinimin se shtesa nga investimi fillestar në Bonot e Thesarit, ka ardhur si rrjedhojë e interesave të përfutur ndër vite, subjekti ka deklaruar se nga babai është bërë gabim njerzor tek deklarata pasurive. Interesat e fituara gjatë viteve, një pjesë janë tërhequr dhe një pjesë tjetër janë lënë për rritjen e depozitës. Për burimin financiar të shumave të depozituara (shtesës 800.000 lekë dhe 300.000 lekë të konfirmuar në RFZ Bank), subjekti shpjegoi se për derdhjen e datës 22.12.2011, shuma 652.800 lekë është kompania INSIG janë kredituar 652.800 lekë, me përshkrimin “pagesë dëmshpërblimi nga TPC Auto DE *** TB”. Për derdhjen e datës 24.12.2012, si burim financiar shpjegoi se kanë shërbyer kursimet e tij, të babait dhe të mamasë. Për praktikën e dokumentacionit të aksidentit, subjekti shpjegoi se është në pritje pasi ka bërë kërkesë pranë kompanisë INSIG.

90. Kërkesë datë 30.10.2023, nga Armir Gjokolaj, drejtuar INSIG, ku kërkon kopje të praktikës së dëmshpërblimit për aksidentin e automjetit me targë GE *** TB, e vlerësuar 652.800 lekë, shumë e cila i është kredituar në llogari në RFZ Bank në datë 21.10.2010. + Dëftesa postare datë 30.10.2023.

Bashkëlidhur subjekti paraqiti:

- Kthim përgjigje nr. ***** prot, datë 06.11.2023, nga kompania INSIG, drejtuar Armir Gjokolaj, ku në përgjigje të kërkesës së tij e informon se: Pranë kësaj kompanie është paraqitur kërkesa për dëmshpërblim për një aksident të ndodhur në datë 27.03.2009, për mjetin e dëmtuar me targë GE ***TB, e cila është paguar në vlerën 652.800 lekë. Në lidhje me praktikën e kërkuar, afati i ruajtjes së dokumentacionit ka kaluar, në këto kushte kompania INSIG nuk e disponon dokumentacioni që kërkohet.
- 91. **Konstatohet se:** Bonot e Thesarit të deklaruara nga babai i subjektit në shumën 1.709.393 lekë, janë çelur fillimisht në formën e depozitës në vitin 2007, në shumën 1.071.940 lekë. Kjo depozite është shtuar ndër vite nga interesat bankare, si dhe nga dy depozitime të kryera nga nëna e subjektit në shumën 800.000 lekë dhe 300.000 lekë dhe më pas është pakësuar për nevoja të mobilimit të apartamentit të blerë në Tiranë, deri sa është investuar në Fond Investimi dhe më pas në Bono Thesari. Në depozitim të shumës 800.000 lekë, si burim financiar ka shërbyer edhe një shumë prej 652.800 lekë, e ardhur nga dëmshpërblimi i përfutur nga një aksident me makinë.
- ✓ **Konfirmohen Bonot e Thesarit deklaruar nga babai i subjektit, me shpjegimet e dhëna, dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank dhe Raiffeisen Invest. Vlera e investuar në vitin 2022 në Bono Thesari është 1.700.000 lekë, ndërsa gjendja në llogari është 20.249 lekë.**
- ✓ **Nga depozita në Raiffeisen Bank në emër të Tereze Gjokolaj, në periudhën 2007 - 2013, janë përfutur interesa në shumën totale rreth 436.500 lekë.**
- ✓ **Nga investimi në Raiffeisen Prestigje nga Pal Gjokolaj, në periudhën 2013 – 2016, janë përfutur interesa në shumën totale rreth 267.000 lekë.**
- ❖ **Subjekti dha shpjegime lidhur me kreditimin nga shoqëria INSIG të shumës 652.800 lekë, për të cilën sqaroi se ka ardhur si dëmshpërblim për automjetin me targa GE *** TB me të cilin është aksidentuar në vitin 2009, subjekti nuk ka paraqitur dokumente justifikuese, por ka**

paraqitur vetem përgjigje nga kompania INSIG, e cila shprehet se afati i ruajtjes se dokumentacionit per aksidentin në fjalë është tejkaluar dhe nuk e disponon dokumentacionin e kërkuar.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane nr. *****, datë 14.12.2022, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor, kaluar ne nr. e llogarisë ***** në BKT të deklaruesit. Shuma 2.000.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit 25% me kontratë nr. ***** rep, nr. *****kol, datë 20.11.2008 (shitur 1.281.000 lekë). Shuma 320.250 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit 33,3% me kontratë nr. *** rep, nr. ***** kol, datë 20.11.2008 (27.12.2017). Shuma 3.486.000 lekë.
- Më datë 25.4.2018 kam bërë kërkesë Drejtorisë së Arkivave Lezhë për pagat si oficer ushtrie nga vitet 1967 - 1.10.2004. Nuk ka ardhur përgjigje.
- Të ardhura nga paga si oficer ushtrie (pensionist) sipas sistemit Raiffeisen Bank nga data 03.12.2004 - 15.10.2009. Shuma 1.406.251 lekë.
- Të ardhura nga pensioni i pleqërisë dhe i ushtarakut sipas sistemit OTP Bank nga data 30.09.2014 - 20.03.2023. Shuma 4.359.263 lekë.
- Më datë 07.03.2023 kam bërë kërkesë Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë për masat e pensionit nga periudha 01.01.2009 - 01.10.2014. Në pritje të përgjigjes.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vendim i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. regjistri *****, datë 05.11.2012, i cili i ka pranuar lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. ***** Regjistri Themeltar, nr. ***** Vendimi, datë 14.02.2012, të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas së cilit është detyruar pala paditëse, shoqëria "INSIG", të dëmshpërbleje paditësin Armir Gjokolaj si dhe personat e tretë (ndërhyrës kryesorë), Mara, Pal dhe Tereze Gjikota, për dëmin pasuror dhe jo-pasuror shkaktuar nga aksidenti i datës 27.03.2009, në shumën totale 9.722.738 lekë e ndarë përkatësisht: Armir Gjokolaj në shumën 1.722.738 lekë si dëm pasuror dhe 2.000.000 lekë si dëm jo pasuror; Mara, Pal dhe Tereze Gjikota secili në shumën 2.000.000 lekë si dëm jo-pasuror.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 20.11.2008, për pasurinë e llojit apartament me sip. 42m², me nr. pasurie *****, Mirditë. Shites: Mara, Pal, Tereze dhe Armir Gjokolaj. Blerës: Gj. L. Çmimi: 1.281.000 lekë, i likuiduar.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. **** kol, datë 27.12.2017, për pasurinë e llojit apartament me sip. 83m², me nr. pasurie *****, Mirditë. Shitës: Pal, Tereze dhe B. Gj, D. D e M. G. Blerës: P. Gj. Çmimi: 3.486.000 lekë, i likuiduar në llogarinë e noterit.
- Kërkesë nr. *** prot, datë 25.04.2018, nga Pal Gjokolaj, drejtuar DRSSH Lezhë, ku kërkon vërtetim për periudhën që nga momenti që i ka lindur e drejta për pension.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Pal Gjokolaj, ku evidentohet kreditimet e pagesave për periudhën 18.02.2005 - 02.02.2009. + Tabelë përmbledhëse.

- Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, për llogari në emër të Pal Gjokolaj, ku evidentohet kreditimet e pagesave për periudhën shtator 2014 - janar 2023. + Tabelë përmbledhëse.
 - Kërkesë datë 07.03.2023, nga Pal Gjokolaj, drejtuar DRSSH Tiranë, ku kërkon vërtetim për masën e pensionit të pleqërisë dhe ushtarak nga periudha 01.01.2009 - 01.10.2014.
- 92. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 07.08.2023,** konfirmon se Pal Gjokolaj, për periudhën 18.02.2005 - 31.12.2008, ka përfituar të ardhura, në shumën 1.331.441 lekë.
- 93. OTP Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 04.08.2023,** konfirmon se Pal Gjokolaj, për periudhën 30.09.2014 - 20.02.2023, ka përfituar të ardhura nga sigurimet shoqërore (dhe interesa llogarie), në shumën 4.409.712 lekë.
- 94. ASHK Rrëshen, me shkresën nr. *** prot, datë 02.10.2023,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit ose personave të lidhur.
- 95. ISSH, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023,** konfirmon se Pal Gjokolaj, nga korrik 2009 përfiton pension suplementar ushtarak me masë mujore aktuale 15.818 lekë dhe prej janar 2020, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 34.617 leke.
- 96. ISSH, me shkresën nr. *** v-prot, datë 17.08.2023,** konfirmon se Pal Gjokolaj, ka të dhëna punësimi për periudhën 1960 - 1964.

→ **Me inventarin e datës 15.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Modelar i vjetërsisë së shërbimit ushtarak aktiv për efekt të sigurimeve shoqërore suplementare, lëshuar nga ISSH, për oficer Pal Gjokolaj. Liruar më datë 29.12.2002. Koha e njohur si vjetërsi shërbimi: 35 vjet, 5 muaj dhe 26 ditë.
 - Vërtetim i lëshuar nga ISSH, për pagën referuese për efekt të përfitimeve nga sigurimet suplementare për ushtarakun Pal Gjokolaj, dalë në rezervë më datë 29.12.2002. Paga e daljes në rezervë: 41.590 lekë. Paga referuese e llogaritur për funksion që ka pas dy vitesh, sipas gradës: 62.600 lekë.
 - Vërtetim nr. 325 prot, dt. 13.11.2023, lëshuar nga ISSH, ku vërteton se Pal Gjokolaj, trajtohet me pension pleqërie me masë mujore aktuale 17.178 lekë/muaj. Të ardhurat për periudhën 01.01.2009 - 01.10.2014, janë në shumën 2.484.625 lekë.
 - Vërtetim për pagën e vlerësueshme mesatare lëshuar nga ISSH, për Pal Gjokolaj, ku për periudhën janar 1994 - janar 2005, ka përfituar të ardhura në shumën 2.166.175 lekë. + Librezë pune për Pal Gjokolaj.
- ✓ **Të ardhurat e babait të subjektit nga punësimi dhe pensioni, për periudhën 1994 - 2023, referuar konfirmimeve bankare dhe dokumentacionit të paraqitur, janë në shumën rreth 10.392.000 lekë.**

DEKLARIMI I PERSONIT TË LIDHUR (NENA) - TEREZE GJIKOLAJ DEKLARIMI I PASURIVE

- 97.** Blerje nga kursimet automjeti Volkswagen me nr. *** rep, nr. ***** kol, datë 22.01.2016. Vlera 50.000 lekë. Zoterimi 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. ** kol, datë 20.10.2016, për automjet Volkswagen Passat. Blerës: Armir Gjokolaj. Shitës: B. M. Çmimi: 3.000 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 06.11.2019, për mjet Volkswagen Passat (targa AA *** OU). Shitës: Armir Gjokolaj. Blerës: Tereze Gjokolaj. Çmimi: 50.000 lekë.

✓ **Trajtuar më sipër.**

98. Llogari bankare OTP Bank e krijuar nga shitja e apartamentit nr. ***** datë 28.12.2017, me vlerë 3.486.000 lekë dhe 500.000 lekë kursime familjare konvertuar me kurs banke 133.5 lekë. Vlera 29.917 euro. Zotërimi 50%.

✓ **Trajtuar më sipër. Deklaruar nga bashkëshorti, Pal Gjokolaj.**

99. Llogari bankare OTP gjendje në llogari rrjedhëse e mbetur nga pensionet. Vlera 11.789 lekë. Zotërimi 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

100. Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, në emër të Tereze Gjokolaj, sipas së cilës, gjendja në llogari në janar 2023, është në shumën 11.789 lekë.

101. **OTP Bank**, me shkresën nr. ***** prot, datë 04.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje 7.507 lekë.

✓ **Gjendja në llogarinë e babait në OTP Bank në datë 04.08.2023 konfirmohet ne vlerën 7.507 lekë. Nëna i subjektit ka deklaruar gjendjen në llogari në muajin janar 2023, në vlerën 11.789 lekë.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

- Të ardhura nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 14.12.2022, nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor, kaluar në nr. e llogarisë ***** në BKT të deklaruesit. Shuma 2.000.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit 25% me kontratë nr. **** rep, nr. **** kol, datë 20.11.2008 (shitur 1.281.000 lekë). Shuma 320.250 lekë.
- Të ardhura nga shitja e apartamentit 33,3% me kontratë nr. **** rep, nr. *** kol, datë 20.11.2008. Shuma 3.486.000 lekë.
- Shitja e automjetit Volkswagen nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016 (blerë me kontratë nr. **** rep, nr. **** kol, datë 12.12.2014. Blerë 3.000 euro. Shitur 15.000 euro.
- Më datë 17.04.2018, kam bërë kërkesë Drejtorisë së Arkivave Lezhë për pagat si arsimtare nga vitet 1972 - 01.10.2004. Nuk ka ardhur përgjigje.

- Të ardhura nga paga si mësuese sipas sistemit Raiffeisen Bank nga data 04.10.2005 - 17.12.2010. Depozita e krijuar në 31.12.2007 i ka kaluar bashkëshortit Pal Gjokolaj më datë 24.12.2013. Shuma 1.796.258 lekë.
- Të ardhura nga pensioni dhe pagesa e invaliditetit sipas sistemit OTP Bank nga data 24.09.2014 - 20.02.2023. Shuma 2.923.693 lekë.
- Më datë 07.03.2023 kam bërë kërkesë Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë për masat e pensionit nga periudha 01.07.2010 - 01.10.2014. Në pritje të përgjigjes.
- Të ardhura nga pensioni i invaliditetit sipas BKT për periudhën 01.10.2014 - 28.01.2015. Shuma 124.300 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vendim i Gjykatës së Rethit Gjyqësor, Tiranë, nr. regjistri *****, datë 05.11.2012, i cili i ka pranuar lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. *****, Regjistri Themeltar, nr. ***** Vendimi, datë 14.02.2012, të Gjykatës së Rethit Gjyqësor, Tiranë, sipas se cilit është detyruar pala paditëse, shoqëria “INSIG”, të dëmshpërblejë paditësin Armir Gjokolaj si dhe personat e tretë (ndërhyrës kryesorë), Mara, Pal dhe Tereze Gjokolaj, për dëmin pasuror dhe jo-pasuror shkaktuar nga aksidenti i datës 27.03.2009, në shumën totale 9.722.738 lekë e ndarë përkatësisht: Armir Gjokolaj në shumën 1.722.738 lekë si dëm pasuror dhe 2.000.000 lekë si dëm jo pasuror; Mara, Pal dhe Tereze Gjokolaj secili në shumën 2.000.000 lekë si dëm jo-pasuror.
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 20.11.2008, për pasurinë e llojit apartament me sip. 42m², me nr. pasurie *****, Mirditë. Shitës: Mara, Pal, Tereze dhe Armir Gjokolaj. Blerës: Gjok Lekgegaj. (Çmimi: 1.281.000 lekë, i likuiduar).
- Kontratë shitblerje nr. ***** rep, nr. ***** kol, datë 12.12.2014, për automjet Volkswagen Bora. Blerës: Terezë Gjokolaj. Shitës: Mirsad Mjellma. Çmimi: 3.000 euro i likuiduar dhe pala blerëse deklaron se nuk ka pretendime për gjendjen teknike. + Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 21.09.2016, për automjet Volkswagen Bora (targa AA***KR). Shitës: Tereze Gjokolaj, përfaqësuar me prokurë nga Armir Gjokolaj. Blerës: N. Xh. Çmimi: 15.000 euro i likuiduar.
- Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, për llogari në emër të Tereze Gjokolaj, ku evidentohen kreditimet e pagesave për periudhën shtator 2014 - janar 2023. + Tabelë përmbledhëse.
- Kërkesë nr. *** prot, datë 25.04.2018, nga Tereze Gjokolaj, drejtuar DRSSH Lezhë, ku kërkon vërtetim për periudhën që nga momenti që i ka lindur e drejta për pension.
- Kërkesë datë 07.03.2023, nga Tereze Gjokolaj, drejtuar DRSSH Tiranë, ku kërkon vërtetim për masën e pensionit të pleqërisë dhe ushtarak nga periudha 01.07.2010 - 01.10.2014.
- Nxjerrje llogarie nga BKT Bank, për llogari në emër të Tereze Gjokolaj, ku evidentohen kreditimet e pagesave për periudhën 08.03.2010 - 21.03.2014. + Tabelë përmbledhëse.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Tereze Gjokolaj, ku evidentohen kreditimet e pagesave për periudhën 04.10.2005 - 16.12.2010. + Tabelë përmbledhëse.

102. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, për periudhën 04.10.2005 - 16.12.2010, ka përfituar të ardhura, në shumën 1.849.211 lekë.

103. BKT, me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, për periudhën 08.03.2010 - 18.08.2014, ka përfituar pagesa invaliditeti në punë në shumën 124.300 lekë.

- 104. OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot, datë 04.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, për periudhën 24.09.2014 - 20.02.2023, ka përfituar të ardhura invaliditeti, sigurimet shoqërore dhe interesa llogarie, në shumën 2.861.418 lekë.
- 105. ISSH**, me shkresën nr. **** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se Tereze Gjokolaj, nga mars 2010 përfiton pension pleqërie me mase mujore aktuale 30.918 lekë.
- 106. ISSH Dega a Arkivit**, me shkresën nr. **** v-prot, datë 17.08.2023, nuk konfirmon të dhëna për Tereze Gjokolaj.

→ **Me inventarin e datës 15.11.2023, subjekti paraqiti:**

- Vërtetim nr. **** prot, datë 13.11.2023, lëshuar nga ISSH, ku vërteton se Tereze Gjokolaj, trajtohet me pension pleqërie me masë mujore aktuale 33.635 lekë/muaj. Të ardhurat për periudhën 01.07.2010 - 01.10.2014, janë në shumën 1.154.873 lekë.
- Librezë punë për Tereze Gjokolaj. + Akt verifikim i vjetërsisë në punë para vitit 1994.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme mesatare lëshuar nga ISSH, për Tereze Gjokolaj, ku për periudhën janar 1994 - tetor 2005, ku ka përfituar të ardhura në shumën 1.741.710 lekë.

- ✓ **Të ardhurat e nënës së subjektit nga pagat dhe pensioni për periudhën 1994 - 2023. Referuar konfirmimeve bankare dhe dokumentacionit të paraqitur janë në shumën rreth 7.732.000 lekë.**

- 107.** Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Armir Gjokolaj ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: Njesia Administrative nr. 1, Rruga “Ali Demi”, Pallati nr. **, Hyrja **, Bashkia Tiranë, si dhe adresën e plotë ku banon: Njesia Administrative nr. 5, Rruga “Plazh – Golem”, Pallati nr. ***, Hyrja nr. **, Bashkia Durrës.

- ✓ **Adresat e deklaruar nga subjekti në Tiranë dhe Durrës, përkojnë me adresat e apartamenteve në pronësi të subjektit.**

- 108.** Banka e Shqipërisë, Intesa Sanpaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Credins Bank, Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, Easypay, Fondi Besa, Insitucioni Financiar NOA, Iute Credit Albania Kredito.al, konfirmojnë se subjekti Armir Gjokolaj, dhe personat e lidhur me **të nuk janë klientë të tyre**, çka konfirmohet me deklarin.

- 109.** Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Librazhd, Mallakastër, Fier, Gjirokastrë, Devoll, Lushnjë, Korçë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kamëz, Vorë, Pukë, Peqin, Skrapar, Bulqizë, Has, Kolonjë, Elbasan, Mirditë, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mat, Shkodër, Sarandë, Krujë, Kurbini, Lezhë **nuk konfirmojnë** pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

110. **AK Invest**, me shkresën nr. **** prot, datë 10.08.2023, **nuk konfirmon** të dhëna për subjektin dhe personat e lidhur me të.
111. **OKB**, me shkresën nr. **** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur **nuk figurojnë** të jenë të pajisur me NIPT si persona fizike apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrit tregtar.
112. **DPT**, me shkresën nr. **** prot, datë 07.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur **nuk figurojnë** të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
113. Drejtoria e Pergjithshme Detare, me shkresën **** prot, datë 11.08.2023, **nuk konfirmon** mjet lundrues në pronësi të subjektit ose personave të lidhur me të.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme 33 dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr.12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktoritetit u mbështetet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Armir Pal Gjokolaj:

- Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- Nuk është kryer deklarim i remë;
- Nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

B. KONTROLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, e Ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germra (ë), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit z. Armie Gjokolaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- ✓ Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- ✓ Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, raporti për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot, datë 03.01.2024, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Armir Gjokolaj.

114. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Ka qenë në hetim/gjykim lidhur me procedimin penal nr. **, datë 25.01.2006 , për nenet 49 të Kodit Penal Ushtarak dhe 250 të Kodit Penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Vendosur Pushimi i Procedimit Penal. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2009, për nenin 290/1 i Kodit Penal. Vendosur **Pushimi i Procedimit Penal**.
- Subjekti ka deklaruar se ka qenë i ndaluar/arrestuar në lidhje me procedimin penal nr. ***/2009, për nenin 290/1 i K. Penal.
- Subjekti ka deklaruar se është caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale ajo e “arrest shtëpie”, për procedimin penal nr. ***/2009, për nenin 290/1 i K. Penal.
- Ndaj tij nuk është lëshuar asnjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së Subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

115. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për subjektin e vlerësimit z.Armir Gjokolaj bën me dije se:

- **Nuk** ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.

116. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj bën me dije se:

- **Nuk** rezulton i dënuar.

117. **Institucion ligjzbatues,** për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- **Nuk** kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.

118. Institucion ligjzbatues,, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare:

- **Nuk** kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- **Nuk** kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- **Nuk** kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
- **Nuk** kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
- Më datë 27.03.2009, subjekti është arrestuar në flagrancë nga strukturat policore të DPQ Lezhë për veprën penale “*Aksidente rrugore*”, parashikuar nga neni 154 i K.Penal.
- **Nuk** kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk** kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- **Nuk** kanë të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
- **Nuk** kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
- Ndaj subjektit Armir Pal Gjokolaj është dhënë masa disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit për 1 vit”, masë e cila është lënë në fuqi me Vendimin e Komisionit Qendror të Apelit nr.***, datë 08.09.2021. Ky vendim është shfuqizuar me Vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. ****, datë 24.11.2021.

119. Institucion ligjzbatues, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, bën me dije se:

- Nuk disponon të dhëna.

120. Institucion ligjbatues, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- **Nuk** kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- **Nuk** ka procedime penale të referuara;
- **Nuk** disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës për subjektin e vlerësimit.

121. Institucion ligjbatues, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj:

- **Nuk** është nxjerrë urdhër ndalimi;
- **Nuk** është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- **Nuk** është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- **Nuk** ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
- **Nuk** ka pasur raste të urdhreve ndërkombëtar të ndalimit.

122. Institucion ligjbatues, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj se:

- **Nuk** është nxjerrë urdhër ndalimi;
- **Nuk** është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- **Nuk** është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- **Nuk** ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
- **Nuk** ka pasur raste të urdhreve ndërkombëtar të ndalimit.

123. Institucion ligjbatues, për subjektin e vlerësimit z. Armir Pal Gjokolaj dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Rezultuan raportime të cilat janë veprime rutinë për subjektin e vlerësimit z. Armir Pal Gjokolaj dhe personat e lidhur me të Tereze Gjokolaj dhe Pal Gjokolaj.

- Nuk rezultuan raportime për personin e lidhur Ch. Gjokolaj.

124. Institucion ligjzbatues, për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), në nivelin “Konfidencial”, lëshuar më datë 27.05.2022, e vlefshme deri më datë 26.05.2027.
- Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohëshëm të CSP.
- AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

125. Avokati i Popullit, për subjektin e vlerësimit z. Armir Pal Gjokolaj bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

126. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për subjektin e vlerësimit Z. Armir Pal Gjokolaj bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorrizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

127. Institucion ligjzbatues, bën me dije se, subjekti i vlerësimit më datë **27.03.2009**, është arrestuar në flagrancë nga strukturat policore të DPQ Lezhë për veprën penale **“Aksidente rrugore”**, parashikuar nga neni 154 i K.Penal, por Prokuroria e Përgjithshme nuk ka relatuar për një rast të tillë.

Në lidhje me relatimin e **Institucion ligjzbatues**, për faktin se subjekti i vlerësimit më datë 27.03.2009, është arrestuar në flagrancë nga strukturat policore të DPQ Lezhë për veprën penale **“Aksidente rrugore”**, në përgjigjen e kthyer prej Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës Parë *****, me shkresën **“I Kufizuar”**, Nr.***Prot, datë 31.10.2023, nuk relaton asnjë të dhënë në ngarkim të subjektit.

Nga studimi i Deklaratës së Kontrollit të Figurës konstatohet se subjekti i vlerësimit z. Armir Gjokolaj ka deklaruar se;

*Mbi bazën e kallëzimit të një shtetasi, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm ***** ka regjistruar **procedimin penal nr.****, datë **25.01.2006**, për veprat penale të “Uljes së dinjitetit të ushtarakut” dhe “Kryerjen e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga nenet 49 të K.P.Ushtarak dhe 250 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve Armir Gjokolaj dhe P. L. Veprimet i janë deleguar Seksionit Ushtarak pranë Prokurorisë Shkodër, ku pas hetimeve në lidhje me këtë procedim*

penal, me vendimin e datës 28.03.2006 është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe aktet i janë përcjellë Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, e cila nga ana e saj ka regjistruar **procedimin penal nr.*** datë 27.04.2006**.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka administruar vendimin e prokurorit të çështjes të datës 11.07.2006, për **pushimin** e këtij procedimi penal.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm ***** ka regjistruar **procedimin penal nr.*** të viti 2009**, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga nenin 290/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Armir Gjokolaj.

Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka administruar vendimin e prokurorit të çështjes të datës 28.05.2010, për **pushimin** e këtij procedimi penal.

128. Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Armir Gjokolaj, **nuk është disponuar asnjë ankese** nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

129. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

Subjekti vlerësimit z. Armir Gjokolaj, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Armir Gjokolaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figures, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se: subjekti i vlerësimit Armir Pal Gjokolaj:

- Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;

- Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Policisë së Shtetit”.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- subjekti i vlerësimit **z. Armir Gjokolaj** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Zëvendës drejtor për sigurinë publike, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës”, dhe me Urdhër Nr. *****, datë 17.12.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

130. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, është struktura përgjegjëse për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport i hollësishëm për subjektin e vlerësimit, me nr**** Prot, datë 01.09.2023, i përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale, në të cilin është konstatuar se:

- **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.**
- **Ka vlerësime pozitive pune.**

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

Punonjësi i policisë z. Armir Gjokolaj, me Urdhër Nr. *****, datë 17.12.2022, është emëruar “Zëvendës drejtor për sigurinë publike, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës”.

Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Armir Gjokolaj, e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Subjekti i vlerësimit ka plotësuar formularin e aftësive profesionale në funksionin e Zëvendës drejtor për sigurinë publike, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Subjekti është emëruar në këtë funksion me Urdhër Nr. *****, datë 17.12.2022. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet

se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE:

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës si dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me ligjin e vlerësimit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Periudha e vlerësimit të aftësive profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e nenit 44 pika 2 dhe 3 të ligjit të vlerësimit.

Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar formularin për vlerësimin e aftësive profesionale në datën 10.03.2023, dhe e ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda afateve ligjore.

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të ofruara nga vetë subjekti;
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standarteve Profesionale pranë DPPSH mbi Performancën e subjektit;

Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe performancës. Nga shqyrtimi dhe analizimi i burimeve të mësipërme, mbi të cilat është mbështetur ky raport vlerësimi, konstatojmë dhe relatojmë si vijon:

131. Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
DND	Akademia e Rendit Publik	1996	1999	Tiranë	Diplomë

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konkludon se niveli arsimor për funksionin që ushtron pranë DPPSH, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale është në përputhje me ushtrimin e detyrës.**

132. Masat Disiplinore:

Referuar raportit të dërguar nga DPPSH, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018- mars 2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

Nga verifikimi në dosjen personale si dhe sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018 - 2023) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, më datë 21.07.2021 ka marrë një masë "Shtyrje afati gradimi 1 vit" të cilën me vendim gjykate Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. *****, datë 24.11.2021 e ka shfyqizuar.

✓ **Deklarimi i subjekti është i saktë.**

133. **Vlerësimet e punës:**

Bazuar në nenin 45, pika 2, shkronja (ç), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë dhe vlerësimet e punës.

Në dosjen e personelit të subjektit gjenden vlerësimet e performancës për vitet 2018 - 2022. Për periudhën 2020, në dosjen personale të subjektit të vlerësimit nuk administrohet vlerësimi i rezultateve individuale të punës. Bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar përgjithësisht në të katërta vitet me thuajse pikët maksimale për punën e kryer si më poshtë:

- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2018 - 31/12/2018, vlerësimi i përgjithshëm është 26 pikë “shumë mire”.
- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2019 - 31/12/2019, vlerësimi i përgjithshëm është 24 pikë “mirë”.
- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2021 - 31/12/2021, vlerësimi i përgjithshëm është 27 “shumë mirë”.
- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2022 - 31/12/2022, vlerësimi i përgjithshëm është 100 “shumë mirë”.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga trupa e vlerësimit, konkludohet:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.**

134. **Të dhëna për Kualifikimet Profesionale, Trajnimet, Konferencat Shkencore.**

Në pikën 3, të formularit të aftësive profesionale, subjekti përgjatë viteve deklaroi pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit, kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit duke cituar edhe certifikatat përkatëse të marra lidhur me këto veprimtari.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë që nuk përfshihet në harkun kohor të sipër cituar mësipër. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018 – mars 2023)

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti nuk ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave konkrete.

Trupa e Vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të DPPSH, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstaton se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, të vlerësimit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

1. Nuk ka realizuar asnjë trajnim;
 2. Nuk ka asnjë kualifikim;
 3. Nuk ka marrë asnjë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.
- ✓ Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti nuk gëzon asnjë kualifikim/trajnimi/medalje.
- ✓ Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.

135. ECURIA NË KARRIERË.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Subjekti i vlerësimit z. Armir Gjokolaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 22 vitesh e 9 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, objekt deklarimi, subjekti ka ecuar në karrierë si vijon:

1. Aktualisht, Zëvendësdyrëtor, i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH-së, nr. ***** datë 17.12.2022.
2. Shef Sektori, në Sektorin FAST Albania, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH-së, nr. ***** datë 29.04.2022.
3. Specialist në Sektorin e Drejtimit pranë Drejtorisë së Menaxhimit dhe Drejtimit në DPPSH. Emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH-së, nr. ***** datë 28.07.2021.

4. Specialist nën mbulim në D. F. P. O, emëruar me urdhër nr. ****, datë 04.12.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH-së.
5. Shef Sektori i Migracionit pranë Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH nr. ***, datë 08.05.2017.

Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti vlerësimit ka përfituar gradën si me poshtë:

- Kryekomisar, dhënë grada me vendim gjyqësor, me Nr. Urdhëri ****, datë 02.05.2018.

✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**

136. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

Subjekti i vlerësimit Armir Gjokolaj për periudhën 2018 - 2023, nuk ka marr pjesë në asnjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER

136. Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Armir Pal Gjokolaj:

- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- Ka vlerësime pozitive pune.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 08.10.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 18.10.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Armir Pal Gjokolaji, në përputhje me nenin 60 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;**
- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;**
- **Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.**

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, **z. Armir Pal Gjokolaj**, me funksion Zëvendësdyrëtor për Sigurinë Publike, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 18.10.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Klevis DHIGOI

Kryesues

Erjana PJETRI

Ersa KARAJ

Relatore

Anëtare